



**RREGULLORE
PËR
FUNKSIONIMIN E BORDIT DREJTUES TË
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË STANDARDIZIMIT (DPS)**

Bazuar në pikën 1 të nenit 10 të ligjit nr.9870 datë 04.02.2008 »Për Standardizimin« dhe pikave 1.5 dhe 9 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.433, datë 05.05.2010 “Për krijimin, përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe kompetencat e Bordit Drejtues të DPS” me propozimin e DPS, miratohet rregullorja e Bordit Drejtues të Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit sipas teksit të mëposhtëm:

**KREU I
PARIME TË PËRGJITHSHME**

1. Hyrje

Bordi Drejtues i Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit, është një nga organet drejtuese të këtij institucioni, misioni i të cilit është sigurimi i transparencës dhe paanshmërisë ndërmjet palëve të interesuara në procesin e vendim-marrjes së standardizimit dhe ruajtja e barazisë të secilës palë në këtë proces.

Bordi krijohet në bazë të pikës 1 të nenit 10 të ligjit nr. 9870 datë 04.02.2008 “Për Standardizimin” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.433, datë 05.05.2010 “Për krijimin, përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe kompetencat e Bordit Drejtues të DPS”.

Bordi përbëhet nga 11 anëtarë, të cilët janë përfaqësues të palëve të ndryshme të interesuara në procesin e standardizimit, respektivisht biznesi, qeveria, konsumatori, akademia. Ky përfaqësim është i tillë, që interesat e palëve të jenë të balancuara, ku e drejta për të propozuar, për t’u informuar dhe për të vendosur të jetë e barazpeshuar ndërmjet palëve.

2. Qëllimi

Kjo rregullore përcakton rregullat për ushtrimin e veprimtarisë së Bordit Drejtues të Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit.

Çdo amendim apo ndryshim i kësaj rregulloreje bëhet me miratimin e ministrit përgjegjës për ekonominë.

KREU II BORDI DREJTUES

1. Kompetencat

1.1 Bordi Drejtues i DPS:

- a) miraton strategjinë e zhvillimit të DPS;
- b) miraton programin vjetor të punës së DPS;
- c) analizon dhe mbikqyr punën e DPS lidhur me zbatimin e programit vjetor të punës;
- d) miraton rregulloren e DPS për përbërjen, kompetencat, funksionimin e Bordit Teknik të DPS dhe kontrollojnë punën e tij;
- e) miraton rregulloret e DPS mbi punën e standardizimit;
- f) jep rekomandime, promovon, krijon dhe mbështet iniciativat për zhvillimin e veprimtarisë së standardizimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- g) miraton marrëveshjet e bashkëpunimit të kontraktuara nga DPS dhe mbështet iniciativat për marrëveshje të reja;
- h) mbështet DPS në plotësimin e kushteve për t'u bërë anëtare me të drejta të plota në organizmat evropiane dhe ndërkombëtare të standardeve, si dhe miraton aplikimin formal për këtë antarësim.

KREU III KRYETARI I BORDIT DREJTUES TË DPS

1. Zgjedhja e Kryetarit

- 1.1 Bordi Drejtues i DPS në mbledhjen e tij të parë zgjedh Kryetarin e tij. Takimi thirret nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili e kryeson atë, pa të drejtë vote, deri sa të zgjidhet Kryetari.
- 1.2 Kandidati për Kryetar do të jetë personi i cili gëzon reputacion të lartë në fushën ku ai operon dhe ka njohuri të thella dhe përvojë në procesin e standardizimit.
- 1.3 Bordi Drejtues zgjedh Kryetarin me votim të fshehtë, me shumicën e votave të anëtarëve të Bordit.
- 1.4 Mandati i Kryetarit është dy vjet. Kryetari nuk mund të rizgjidhet për më shumë se dy mandate rradhazi.

2. Lirimi i Kryetarit

2.1 Kryetari lirohet nga detyra e tij përpara skadimit të mandatit:

- a) me kërkesën e tij;
- b) në rast se nuk ka përmbushur detyrat për më shumë se tre muaj;
- c) në rast se humbet zotësinë juridike për të vepruar në kryerjen e detyrave të tij;
- d) nëse, me sjelljet e tij, rrezikon reputacionin e DPS dhe të Bordit të saj.

2.2 Çdo anëtar i Bordit Drejtues apo Drejtori i Përgjithshëm i DPS kanë të drejtën të propozojnë, me shkrim dhe të argumentuar, për një ose disa nga shkaqet e lartpërmendura, lirimin nga detyra të Kryetarit të Bordit.

2.3 Kryetari lirohet nga detyra me votim të fshehtë, me shumicën e votave të anëtarëve të Bordit.

3. Kompetencat e Kryetarit

3.1 Kryetari i Bordit Drejtues të DPS, ka këto kompetenca:

- a) thërret dhe drejton mbledhjet e zakonshme të Bordit;
- b) thërret mbledhjet e jashtëzakonshme mbas këshillimit me Drejtorin e Përgjithshëm të DPS kur gjykohet se problemi ka karakter urgjent;
- c) kontrollon zbatimin, nga të gjithë anëtarët e Bordit, të detyrave të lëna në takimet e mëparshme;
- d) nënshkruan vendimet dhe rregulloret e miratuara nga Bordi Drejtues, dhe mbikqyr zbatimin e tyre;
- e) përcakton mënyrën e publikimit të vendimeve të Bordit Drejtues.

KREU IV ANËTARËT E BORDIT DREJTUES TË DPS

1. Zgjedhja e anëtarëve

- 1.1 Emrat e kandidatëve paraqiten në DPS nga institucionet përkatëse, në përputhje me kërkesat e dhëna në pikat 1.1, 1.2 dhe 1.3 të VKM nr.433, datë 5.5.2010 “Për krijimin, përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe kompetencat e Bordit Drejtues të DPS”.
- 1.2 DPS ka të drejtë të kthejë kandidaturat e ardhura nëse vëren se ato nuk janë në përputhje me kërkesat e dhëna në VKM nr.433, datë 5.5.2010 “Për krijimin, përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe kompetencat e Bordit Drejtues të DPS”.
- 1.3 Përfaqësuesit e palëve të interesuara për anëtarë të Bordit Drejtues duhet të jenë në nivele drejtuese në institucionet e tyre dhe të kenë njohje dhe kontribut në hartimin, adoptimin dhe përdorimin e standardeve.
- 1.4 Anëtarët e Bordit Drejtues qëndrojnë në këtë detyrë për një mandat 2 (dy) vjeçar me të drejtë ri-emërimi edhe për një mandat të dytë radhazi.

2. Lirimi i anëtarit

- 2.1 Një anëtar i Bordit Drejtues mund të lirohet nga detyra përpara mbarimit zyrtar të mandatit të tij:
 - a) me kërkesën e tij;
 - b) në qoftë se personi juridik që përfaqësohet e kërkon këtë për shkak se anëtari i Bordit Drejtues nuk ka prezantuar interesat e atij subjekti;
 - c) nëse nuk ka përmbushur detyrat si anëtar i Bordit Drejtues për më shumë se dy mbledhje radhazi;
 - d) nëse humbet zotësinë për të vepruar në kryerjen e detyrave të ngarkuara, dhe;
 - e) nëse me sjelljet e tij, rrezikon reputacionin e DPS dhe Bordit Drejtues.

2.2 Kryetari i Bordit Drejtues ose Drejtori i Përgjithshëm i DPS kanë të drejtën të propozojnë, me shkrim dhe në mënyrë të argumentuar, për një ose disa nga shkaqet e lartpërmendura, lirim nga detyra të një anëtarit të bordit.

2.3 Anëtarit i Bordit Drejtues të DPS lirohet nga detyra e tij para mbarimit të mandatit, si anëtar i këtij Bordi, me votim të fshehtë, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Bordit.

2.4 Pas përfundimit të parakohshëm të mandatit të anëtarit të Bordit Drejtues, institucioni përkatës propozon një përfaqësues tjetër në vend të tij për përfundimin e mandatit të nisur, brenda një afati 2 (dy) javor, nga marrja e njoftimit zyrtar, për lirimin e anëtarit të mëparshëm.

3. Detyrat e anëtarëve

3.1 Anëtarët e Bordit Drejtues janë të detyruar të marrin pjesë në mbledhjet e Bordit Drejtues. Ato informojnë Sekretarin e DPS për ndonjë mungesë të arsyetuar të paktën 3 (tre) ditë para datës së mbledhjes.

3.2 Anëtarët e Bordit Drejtues të pranishëm në takim janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e përmbajtjes së diskutimeve, kur materialet janë të shënuara si “konfidenciale”, ose kur ka të dhëna personale të kandidatëve.

KREU V MBLEDHJET E BORDIT DREJTUES TË DPS

1. Thirrja e mbledhjeve

1.1 Bordi Drejtues i DPS mbledhet dy herë në vit. Mbledhjet thirren dhe kryesohen nga Kryetari.

1.2 Në rast të mungesës së Kryetarit, anëtarit më i vjetër i Bordit Drejtues do të kryesojë mbledhjen të Bordit Drejtues.

1.3 Kryetari i Bordit Drejtues thërret mbledhjen e jashtëzakonshme të Bordit Drejtues, nëse kjo është kërkuar, duke dhënë dhe arsyet me shkrim, nga:

- a) së paku 5 (pesë) anëtarë të Bordit;
- b) Drejtori i Përgjithshëm i DPS.

1.4 Kryetari duhet të vendosë gjithashtu, mbas këshillimit me Drejtorin e Përgjithshëm të DPS, për kërkesat e tjera me shkrim për një takim të Bordit Drejtues dhe brenda 8 (tetë) ditësh pune nga pranimi i kërkesës, personi, i cili ka bërë kërkesën, do të informohet me shkrim mbi vendimin e Kryetarit.

2. Pjesëmarrja e DPS në Bordin Drejtues

2.1 Drejtori i Përgjithshëm, Drejtorët e Departamenteve dhe Kryetari i Bordit Teknik të DPS, marrin pjesë në mbledhjet e Bordit Drejtues pa të drejtë vote.

2.2 Ata janë të detyruar të ruajnë, si sekret pune, përmbajtjen e diskutimeve, në rastin e materialeve që janë shënuar si konfidenciale, ose kur diskutohen të dhëna personale të kandidatëve.

3. Vendi dhe komunikimi për mbledhjen e Bordit Drejtues

3.1 Vendi ku mbahen mbledhjet e Bordit Drejtues është selia e DPS.

3.2 Kryetari i Bordit Drejtues në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të DPS përgatit axhendën e mbledhjes, bazuar në problematikat e propozuara nga DPS.

3.3 Çdo anëtar i Bordit Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm i DPS kanë të drejtë të bëjnë propozime për pikat e rendit të ditës.

3.4 Njoftimet për mbledhjet e Bordit Drejtues, së bashku me rendin e propozuar dhe materialet përkatëse, do t'i dërgohen anëtarëve të Bordit, Kryetarit të Bordit Teknik të DPS dhe pjesëmarrësve të tjerë në mbledhje jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë para datës së takimit.

3.5 Njoftimi do të përfshijë numrin e protokollit, datën, orën (si edhe afatin e fundit për dhënien e përgjigjes, kur ka korespondencë), një projekt-axhende dhe një specifikim të materialeve të bashkëlidhura.

3.6 Në raste të veçanta, Kryetari dhe/ose Sekretari i Bordit mund të komunikojë nëpërmjet korespondencës me shkrim (me postë, fax ose email) me anëtarët e Bordit Drejtues. Ky komunikim do të bëhet duke i siguruar të gjithë anëtarëve të Bordit të japin mendimet e tyre me shkrim lidhur me pikat përkatëse të rendit të ditës, si dhe me projekt-vendimet e propozuara.

3.7 Kur bëhet një votim formal, merren në konsideratë vetëm përgjigjet me shkrim dhe të nënshkruara nga anëtarët e Bordit. Këto përgjigje konsiderohen edhe në rastin kur ato dërgohen me faks ose me email të skanuar, ku është firma e antarit.

4. Zhvillimi i mbledhjes

4.1 Bordi Drejtues krijon kuorumin e tij me 2 / 3 e anëtarëve të tij të pranishëm në takim.

4.2 Pasi evidentohet prania e kuoromit, Kryetari i Bordit propozon rendin e ditës për miratim.

4.3 Çështje të veçanta të axhendës mund të shtyhen deri në takimin e ardhshëm, në rastin kur anëtarët e pranishëm kërkojnë më shumë informacion në dispozicion për të diskutuar dhe votuar për to.

4.4 Çdo anëtar i Bordit Drejtues, Drejtori i Përgjithshëm i DPS ose Kryetari i Bordit Teknik, mund të propozojë një amendament ose korrigjim në rendin e ditës. Anëtarët e Bordit Drejtues do të vendosin për ndryshimet në rendin e ditës me shumicë të thjeshtë votash.

4.5 Gjatë mbledhjes, kur diskutohet mbi çështjet e propozuara të axhendës, Kryetari i jep, anëtarëve të Bordit Drejtues dhe personave të tjerë të pranishëm, të drejtën për të diskutuar mbi çështjen e radhës. Folësi do të mund të diskutojë vetëm për çështjet e vendosura në rendin e ditës. Kur folësi devijon nga çështja, Kryetari duhet së pari ta paralajmërojë atë për devijimin, dhe kur folësi nuk i përgjigjet pozitivisht paralajmërimit, t'i ndërpresë fjalën. Kryetari ka të drejtën t'i lejojë sejcilit nga folësit një kohë të arësyeshme për diskutim dhe vetëm një herë për të njejtën çështje.

4.6 Pas shqyrtimit të materialeve të shkruara dhe pas diskutimit, Kryetari i hedh ato në votim.

4.7 Vendimet merren me votim të hapur, me shumicën e votave të pjesëmarrësve në takim.

4.8 Vendimet e marra në çdo mbledhje të Bordit Drejtues kanë efekt detyrues për të gjithë anëtarët të pranishëm dhe për ata që nuk janë prezent në votim.

4.9 Në raste të veçanta, kur anëtari mungon me arësye, është i vlefshëm mendimi i tij dhënë në mënyrë elektronike. Kjo përgjigje duhet dërguar të paktën 1 (një) ditë para mbledhjes.

5. Sekretari i Bordit

5.1 Sekretari i Bordit Drejtues caktohet nga DPS. Ai është një nga punonjësit e DPS dhe kjo është detyrë shtesë e tij, krahas detyrave për pozicionin e punës që ka në DPS.

5.2 Sekretari përgjigjet për organizimin e mbledhjes, përgatit infrastrukturën, njoftimet dhe dokumentacionin përkatës.

5.3 Sekretari mban procesverbalin e takimit të Bordit Drejtues, i cili duhet të përmbajë:

- a) pjesëmarrjen në mbledhjen e Bordit Drejtues;
- b) rendin e ditës, të miratuar;
- c) një përmbledhje për përmbajtjen e diskutimeve;
- d) vendimet e marra, dhe;
- e) rezultatet e votimit.

5.4 Një listë prezence me nënshkrimet e anëtarëve të Bordit Drejtues dhe personat e tjerë të pranishëm në takim do të jetë bashkëlidhur, si pjesë e pandarë e procesverbalit.

5.5 Materiali i plotë i takimit të Bordit Drejtues duhet t'i bashkëlidhet njoftimit origjinal dhe procesverbalit. Një kopje e tij e protokolluar mbahet nga Sekretari i Bordit në dosje të veçantë në arkivën e DPS.

5.6 Procesverbali firmoset nga Kryetari dhe nga Sekretari i Bordit. Procesverbali miratohet në mbledhjen tjetër të Bordit, në rastin kur nuk arrihet të miratohet gjatë mbledhjes aktuale.

5.7 Mbledhja e Bordit Drejtues mund të shtyhet në rastet kur nuk arrihet kuorumi i nevojshëm. Mbledhja mund të shtyhet brenda 30 ditëve.

6. Vendim-marrja dhe votimi

6.1 Bordi Drejtues i miraton vendimet me votim të hapur, me shumicë absolute të votave të anëtarëve të pranishëm, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe.

6.2 Votimi kryhet me një ngritje të dorës. Çdo anëtar i Bordit drejtues ka një votë.

6.3 Votat numërohen nga Sekretari i Bordit Drejtues dhe regjistrohen në procesverbalin e takimit.

6.4 Bordi Drejtues i miraton vendimet me votim të fshehtë në rastet kur:

- a) bëhet zgjedhja e Kryetarit të Bordit;
- b) hidhet në votim lirimi i anëtarit të Bordit përpara përfundimit të mandatit të tij dy-vjeçar.

KREU VI
DISPOZITA TË FUNDIT

1. Zbatimi

1.1 Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit për zbatimin e kësaj rregulloreje.

1.2 Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

Anëtarët e Bordit Drejtues të DPS

1. **Besjan Pesha** Drejtor i Përgjithshëm i Politikave Tregtare-Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës
2. **Agim Anxhaku** Drejtor i Reformës Rregullatore dhe Infrastrukturës së Cilësisë-Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës
3. **Ilir Qerfozi** Drejtor i i Drejtorisë së Politikave të Ndërtimit-Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
4. **Lida Llakmani** Këshilltare e Ministrit-Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
5. **Genti Guxho** Prof.As-Universiteti Politeknik i Tiranës
6. **Elvis Pazaj** Drejtor i Qendrës së Kërkimeve dhe Trajnimeve të Biznesit-Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë
7. **Gjergj Buxhuku** Administrator i Përgjithshëm-Konfindustria
8. **Gëzim Karapici** Drejtor i Përgjithshëm-Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit
9. **Durim Grabova** Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse-Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë
10. **Altin Goxhaj** Drejtor i Shoqatës për Mbrojtjen e Konsumatorit - ZMK
11. **Ilir Rëmbeçi** Drejtor Ekzekutiv-Agjensia Rajonale e Zhvillimit, Tiranë